

BARKODI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE**

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2025

KUALIFIKIMI PROFESIONAL "VETERINARI "

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30		
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Cila prej simptomave klinike është shenjë kryesore në shpendët me sëmundjen e Kolerës? **1 pikë**
- A) Zhurma trakeale dhe rrjedhje nga hunda;
 - B) Diarre me ngjyrë të gjelbër dhe pa gjak;
 - C) Diarre dhe absese në artikulacione;
 - D) Diarre dhe zmadhim i vëllimit të barkut;
2. Mikrobi patogjen, kur futet ne organizmin e kafshës, shpreh agresivitetin e tij kur: **1 pikë**
- A) Ka shkallë të lartë patogjeniteti;
 - B) Prodhon helme në organizëm;
 - C) Futet me forcë në organizëm;
 - D) Ka aftësi për t'u shumëzuar në organizëm;
3. Simptoma klinike karakteristike për sëmundjen infektive të Murtajës së gjedhit është: **1 pikë:**
- A) Çrregullime në indin dhe organet hemopoetike;
 - B) Pezmatim kataral e gjakrrjedhës i aparatit tretës;
 - C) Hemoglobinuri dhe ikter i theksuar;
 - D) Diarre e fortë dhe anem;
4. Shkaktari i sëmundjes së Paratifos në dhen është: **1 pikë**
- A) Salmonella abortus ovis;
 - B) Paludis ovitoxicus;
 - C) Bacilli Necrophorum;
 - D) Micrococcus matitis ovis;
5. Në burimet dytësore të përhapjes së infeksionit hyjnë: **1 pikë**
- A) Tokat e infektuara me mikrobe;
 - B) Kafshët bacilmbartëse mekanike;
 - C) Kafshët e ngordhura;
 - D) Prodhimet blegtorale;
6. Antitruapat specifike që kur ngjiten me qelizën mikrobike, bien në fund të epruvetës në trajtën e një mase të trashë janë: **1 pikë**
- A) Bakteriolizinat;
 - B) Hemolizinat;
 - C) Aglutininat;
 - A) Opsaninat;
7. Metoda e diagnostikimit që bazohet në qëndrimin e kafshës në hapësirë quhet: **1 pikë**
- A) Askultimi;
 - B) Anamneza;
 - C) Palpimi;
 - D) Shikimi;

8. Shenja klinike karakteristike në sëmundjet e parastomakeve kur ka tejmbushje të rumenit është: **1 pikë**
- A) Peristaltika e parastomaqeve e dobësuar;
 - B) Fermentimi i shpejtë i ushqimeve;
 - C) Paaftësia e përzierjes së ushqimeve;
 - D) Grumbullimi i gazeve ne rumen;
9. Kur gjatë kontrollit të lëvizjeve të frymëmarrjes, vlerësohet frymëmarrja kosto-abdominale është: **1 pikë**
- A) Frekuenca e frymëmarrjes;
 - B) Dispnea e frymëmarrjes;
 - C) Ritmi i frymëmarrjes;
 - D) Tipi i frymëmarrjes;
10. Kur gjatë kontrollit të aparatit tretës në kafshë, vërejmë pezmatime të ezofagut nga trupa të huaj, çrregullimi është i: **1 pikë**
- A) Aktit të ripërtypjes;
 - B) Marrjes së ushqimit;
 - C) Aktit të përtypjes;
 - D) Aktit të gëlltitjes;
11. Sëmundja e Bronkopneumonisë lind nga: **1 pikë**
- A) Pezmatimi i mukozës së bronkeve;
 - B) Pezmatimi i bronkeve dhe alveolave;
 - C) Zmadhimi i alveolave të mushkërisë me ajër;
 - D) Mbushja e alveolave me produktet e pezmatimit;
12. Cila nga pjesët e mëposhtme përfaqëson trupin e cestodëve? **1 pikë**
- A) Strobila;
 - B) Skoleksi;
 - C) Proglotidet;
 - D) Onkosfera;
13. Shkenca që studion sëmundjet e bimëve, kafshëve dhe njerëzve, të cilat shkaktohen nga organizma njëqelizorë, krimbt dhe këmbënyjtuar është: **1 pikë**
- A) Zoologjia;
 - B) Parazitologjia;
 - C) Fitoparazitologjia;
 - D) Zooparazitologjia;
14. Cila nga shenjat klinike të mëposhtme është tipike për sëmundjen parazitare Estroza e dhenve? **1 pikë**
- A) Pezmatime dhe ulçerizime në mukozën e gojës;
 - B) Tështitje dhe kruarje të hundëve;
 - C) Pezmatime dhe gjakrrjedhje në lëkurë;
 - D) Kruarje të lëkurës dhe gungëzime në shpinë;

15. Në sëmundjet e gjirit, shenja kryesore në mastitet subklinike është: **1 pikë**

- A) Kuagula të kazeinës në qumësht;
- B) Atrofizimi i gjëndrës së gjirit;
- C) Shtimi i indit lidhor në gji;
- D) Pezmatim i zgjatur i gjirit;

16. Kur dështimi që ndodh te kafsha, shoqërohet me macerimin e frytit është: **1 pikë**

- A) Masë që thithet nga mukoza e mitrës;
- B) Masë gjysëm e tejdukshme;
- C) Prishje të frytit të dështuar;
- D) Tharje të frytit të dështuar;

17. Sipas funksionit të cipave të frytit, cila cipë siguron të ushqyerit e frytit në mitër: **1 pikë**

- A) Urinare;
- B) Ujore;
- C) Enëzore;
- D) Urino-enezore;

18. Cila prej patologjive të kafshës pas pjelljes, vërehet vetëm gjatë pjelljes ose disa orë pas saj? **1 pikë**

- A) Damllaja e qumështit;
- B) Mbetja e shtratit;
- C) Prolapsi i vaginës;
- D) Prolapsi i mitrës;

19. Gjatë kontrollit rektal, në cilën patologji të vezoreve, vezorja e prekur është e zmadhuar? **1 pikë**

- A) Salpingitis;
- B) Ovaritis;
- C) Atrofi e vezoreve;
- D) Ciste te vezoreve;

20. Në cilën prej patologjive të organeve gjinore mukoza e vaginës është e rrudhosur? **1 pikë**

- A) Vaginitin katarral;
- B) Vaginitin nekrotik;
- C) Vaginitin qelbëzor;
- D) Vaginitin gangrenoz;

21. Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

Në fermën ku mbarështohen lopë, nga të dhënat e anamnezës lopa shfaq këto shenja klinike: nga vulva vërehet e varur një masë me ngjyrë trëndafili, vërehen karunkulat, masa arrin deri në artikulacionin e trinës etj.:

4 pikë

A) Çfarë patologji vërehet? _____

B) Renditni 3 (tre) mënyra të ndërhyrjes lokale.

1) _____

2) _____

3) _____

22. Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

Gjatë kontrollit rektal në lopë dallohen vezoret e zvogëluara, të lëmuara, pa folikula, mitra dhe brirët e mitrës të zbutura etj.: **4 pikë**

A) Çfarë patologji të organeve gjinore vërehet? _____

B) Renditni 3 (tre) mënyra kryesore të trajtimit:

1) _____

2) _____

3) _____

23. Rrethoni përgjigjen e saktë në pohimet e mëposhtme.

4 pikë

a) Mënyra e Fylbornit, bazohet në parimin e fundërrimit të vezëve të helmintëve në fekalet e kafshëve

PO JO

b) Mënyra e helmintoskopisë bazohet në gjetjen e helmintëve të rritur në fekalet e kafshëve

PO JO

c) Mënyra e Bermanit bazohet në parimin e nxjerrjes së vezëve të helmintëve në sipërfaqe të lëngut

PO JO

d) Mënyra e Vajdes bazohet në gjetjen e larvave të helmintëve në fekalet e dhenve e dhive.

PO JO

24. Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

Nga të dhënat e anamnezës, lopa paraqet këto shenja: gjiri i enjtur, me lëkurë të tendosur pa rrudha, i padhembshëm e me temperaturë më të ulët se të trupit, qumështi nuk është i prishur. **4 pikë**

A) Çfarë patologji vërehet? _____

B) Listoni 3 (tre) nga mënyrat kryesore të trajtimit:

1) _____

2) _____

3) _____

25. Rrethoni përgjigjen e saktë në pohimet e mëposhtme.

4 pikë

a) Dezinfektimi me djegie siguron zhdukjen e plotë të të gjitha mikrobeve e të viruseve.

PO JO

b) Dezinfektimi me rrezatim realizohet me flakëhedhëse, që ushtrojnë veprim vdekjeprurës mbi mikrobet.

PO JO

c) Dezinfektimi i detyruar bëhet vazhdimisht, në mënyrë të planifikuar dhe me intervale të caktuara kohe.

PO JO

d) Dezinfektimi parambrojtës bëhet kur shpërthen një sëmundje ngjitëse dhe drejtohet kundër shkaktarit të sëmundjes.

PO JO

26. Plotësoni vendet bosh me përgjigjen e saktë në pohimet e mëposhtme.

4 pikë

- a) Për dëgjimin e punës së organeve të ndryshme bazohemi në mënyrën e _____.
- b) Të dhënat për dinamikën e sëmundjes që jep shoqëruesi i kafshës bazohen në _____.
- c) Për të përcaktuar gjendjen fizike të organeve dhe të indeve lidhur me gjendjen ose jo të ajrit në to bazohemi në mënyrën e _____.
- d) Temperaturën, konsistencën, ndjeshmërinë, si dhe trajtën e madhësinë e zonës së sëmurë e vlerësojmë me mënyrën e _____.

27. Cila prej sëmundjeve infektive në të imta shfaqet me prekje të syrit.

4 pikë

Rrethoni përgjigjen e saktë:

- a) Agalaksia
- b) Enterotoksiemia

Përshkruani shenjat klinike në sëmundjet e mëposhtme.

- a) Agalaksia _____

- b) Enterotoksiemia _____

- c) Cila është profilaksia specifike për këto sëmundje?

28. Cila prej sëmundjeve të aparatit të frymëmarrjes shfaqet te kafsha me frymëmarrje që zgjatet, gjatë inspirimit të thellë zgjat qafën dhe hap flegrat e hundëve, alveolat zgjerohen dhe tendosen etj.:

4 pikë

Rrethoni përgjigjen e saktë.

- A) Pneumonia
- B) Emfizema

Cila është ngjashmëria në këto sëmundje?

- _____
- Çfarë ndodh në secilën prej këtyre sëmundjeve në kafshë?
- Në pneumoni _____

- Në emfizemë _____

29. Cila nga sëmundjet parazitare shfaqet me formime të gungave në shpinë?

4 pikë

Rrethoni përgjigjen e saktë

A) Estrozë B) Hipodermozë

Cila është ngjashmëria në këto sëmundje parazitare

Përshkruani shenjat klinike në sëmundjet e mëposhtme:

Estrozë _____

Hipodermozë _____

30. Sëmundja infektive që shfaqet në shpendë me prekje të sistemit limfoid quhet:

4 pikë

Rrethoni përgjigjen e saktë.

A) Pseudomurtaja e shpendëve B) Mareku

Përshkruani shenjat klinike të secilës sëmundje infektive të shpendëve.

Pseudomurtaja e shpendëve _____

Mareku _____

Cila është ngjashmëria në këto sëmundje?

